



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 16.02.2022, Nr. 09.MI-7228



Në bazë të nenit 64 pika 1 e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyratet Publike të Republikës së Kosovës, në vështrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Drejtorati për Arsim në Drenas, shpallë:

KONKURS

- 1. SHFMU” Halil Bajraktari “ në Drenas II**
 - Një mësimdhënës/e për TIK, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit pa pagesë, më mundësi vazhdimi.
- 2. SHFMU” Jusuf Gërvalla “ në Negroc**
 - Dy mësimdhënës/e për arsim fillor, deri sa të kthehen punëtorët prej pushimit të lehonisë.
- 3. SHFMU” Shotë Galica “ në Tërdec**
 - Një mësimdhënës/e për arsim fillor, deri me datën 31.01.2023, më mundësi vazhdimi.
- 4. SHFMU” Dëshmoret e Qendresës II “ në Tërstenik**
 - Një mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe, deri sa të kthehet mësimdhënësi prej pushimit mjekësor, më mundësi vazhdimi.
- 5. SHFMU” Naim Frashëri “ në Gllobar**
 - Një Edukatore, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit pa pagesë, më mundësi vazhdimi.
- 6. SHFMU” Azem Bejta “ në Shtuticë**
 - Një mësimdhënës/e për 12 orë Kimi, prej tyre 6 orë në shkollën e lartëcekur dhe 6 orë në SHFMU” Dëshmorët e Qendresës II” në Tërstenik, deri me 31.08.2022, më mundësi vazhdimi.
- 7. SHFMU” Fehmi dhe Islam Kastrati “ në Kizhnarekë.**
 - Një Edukatore, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit të lehonisë.
- 8. SHFMU” Bajram Curri “ në Nekoc**
 - Një mësimdhënës/e e Gjuhës Shqipe, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit mjekësor, të lehonisë.
- 9. SHFMU” Fazli Greiçevci “ në Vasilevë**
 - Një mësimdhënës/e Gjeografi- Edukatë Qytetare, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit të lehonisë.
- 10. SHML” GJ.K.Skënderbeu “ në Drenas**
 - Një mësimdhënës/e për Edukatë Qytetare me 20 orë, prej tyre 13 orë në shkollën e lartëcekur, deri sa të kthehet mësimdhënësi prej pezullimit dhe 7 orë Gjeografi në SHFMU” Rasim Kiçina” në Drenas deri me 31.08.2022, me mundësi vazhdimi.

KUSHTET E PUNËSIMIT:

Për të gjitha vendet e punës kërkohet përgatitje adekuate profesionale (me fakultete përkatëse), sipas U.A.05 / 2021 - MASHTI.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, patentë shofer ose pasaportë)
3. Diploma ose Çertifikata e diplomimit- jo më e vjetër së gjashtë muaj, e vërtetuar ne Komunë ose te Noteri publik.
4. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më e vjetër së gjashtë muaj.
5. Vërtetim i përvojës së punës vetëm në arsim (nëse keni).
6. Çertifikatë mjekësore për gjendjen shëndetësore lidhur me çështjen e punësimit, për kandidatët që pranohen në punë.
7. Kopje të Çertifikatave të trajnimeve përkatëse (nëse keni)

REKRUTIMI:

Intervistat me shkrim më gojë dhe përzgjedhjen e kandidatëve do ta bëjë Komisioni i përzgjedhur nga DKA.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurim merret në zyrat e DKA-së,të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit, Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurrimit dhe dokumentet shtesë jashtë dorëzimit në arkiv nuk pranohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Drenas,
Më:16.02.2022

